



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:285310

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05844777

C.nr.1153/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.G, nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati Y.B, nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike për kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit, vlera e objektit të kontestit 1.000.00 euro, jashtë seancës, më datën 21.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses D.G nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të “detyrohet e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D.G nga Gjakova, për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri me 31.07.2016, në emër të diferencës në pagë ti paguaj shumën prej 1,051.65 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 16.12.2021 (pra nga dita e ushtrimit të padisë e deri më sot), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.

DETYROHET paditësja D.G që të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 104,00 euro, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësi D.G, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 16.12.2021, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompenzimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit, në shumën prej 1,051.65 euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 18.05.2023, ka theksuar se e kontestojmë kërkesëpadinë e paditëses ndaj të paditurës, ngase konsideron se padia si e tillë është e pa themeltë dhe e pabazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit. Gjithashtu, padia e paditëses është e pas afatshme, nuk ka bazë të qëndrueshme

ligjore, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse, rezulton se është parashkruar në tërësi.

Paditësja ka ushtruar padi në gjykatë më 16.12.2021, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shtesave në pagë në bazë të kualifikimit, për periudhën kohore prej 01.01.2015 deri më 31.07.2016, që të njëjtën e konteston si të pa themeltë dhe atë për shkak të parashkrimit, ngase paditësja kërkesën e saj e ka mbështetur në Kontratën Kolektive të arsimit të datës 11.04.2014, e cila kontratë nuk është më në fuqi dhe nuk ka qenë në fuqi as në kohën e parashtrimit të padisë më 16.12.2021 dhe të njëjtën e bën të pazbatueshme, ngase periudha me të cilën kërkohet kompensimi dhe baza ligjore në të cilën mbështetet kërkespadija nuk përkojnë me njëra tjetrën.

Gjithashtu, paditësja kërkesën e ka mbështetur në KKA të datës 18.04.2017 e cila kontratë nuk mund të zbatohet në rastin konkret, ngase periudha e cila kërkohet kompensimi është nga data 01.01.2015 deri më 31.08.2016, pra periudha e cila nuk ka qenë në fuqi KKAK e datës 18.04.2017 dhe si e tillë nuk mund të zbatohet ngase e njëjta nuk ka efekt retroaktiv dhe si rezultat padia dhe kërkespadija e paditëses është e pa themeltë dhe pa mbështetje ligjore.

Po ashtu, ka theksuar se paditësja nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë të rregullt administrative pranë të paditurës, ku në bazë të shkresave të lëndës shihet që paditësja nuk ka parashtruar ndonjë ankesë apo kërkesë pranë punëdhënësit.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 542/15 e datës 10.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; diploma me Nr.127/16 e datës 29.08.1973 e lëshuar nga Shkolla Normale “H.Zajmi” në Gjakovë; licencën e mësimdhënësit Nr. 100008260 e lëshuar më datën 26.12.2012 e Ministrisë së Arsimit, si dhe lista e pagës të datës 01 Shtator 2015 dhe 01 Korrik 2016.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses pagesa e shtesave në bazë të kualifikimit.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 542/15 e datës 10.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.G kishte të themeluar marrëdhënien e punës te e paditura.

Me administrimin e diplomën e datës 29.08.1973, Nr.127/16, e lëshuar nga Shkolla Normale “ H. ZAJMI” në Gjakovë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.C, ka përfunduar Shkollën Normale, dhe mori titullin Mësuese.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 10008260 e lëshuar më datën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është licencuar me licencë të mësimdhënësit nga data 26.12.2012.

Me administrimin e listës së pagave për muajin Shtator 2015 për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se në muajin shtator të vitit 2015, paditësja D.G, në këtë periudhë kishte pagën bazë prej 405 euro.

Me administrimin e listës së pagave për muajin Korrik 2016 për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se në muajin korrik të vitit 2016, paditësja D.G, në këtë periudhë kishte pagën bazë prej 405 euro.

Gjykata ka vendosur ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses për faktin se paditësja ka kërkuar në periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri me 31.07.2016 në emër të diferencës në pagë ti paguaj shumën prej 1,051.65 euro, prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 16.12.2021.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 82 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, nenit 87 të Ligjit të Punës dhe nenit 399 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit dhe 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1153/21, më datën 21.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.